



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI KONKURENCËS

Nr. 367/prot.
3

Tiranë, më 05.07.2023

VENDIM

Nr. 999, Datë 05.07.2023

**“PËR ZËVENDËSIMIN E PËRKOHSHËM NË KRYERJEN E DETYRAVE
FUNKSIONALE TË SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 05.07.2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Zëvendësimi i përkohshëm në kryerjen e detyrave funksionale të Sekretarit të Përgjithshëm, znj. Diana Dervishi.

Baza Ligjore: Nenet 24, germa d, nenet 27, pika 1 dhe Urdhrit nr. 20 datë 27 qershor 2023 “Për ngritjen e Komisionit Disiplinor”

Komisioni i Konkurrencës, pas vlerësimit të procedurave të deritanishme në lidhje me ecurinë e procedimit disiplinor ndaj znj. Diana Dervishi dhe sigurimit të mbarëvajtjes administrative në Autoritetin e Konkurrencës,

VËREN SE :

Komisioni i Konkurrencës, në mbledhjen e datën 27 qershor 2023 shqyrtoi rendin e ditës “Disa problematika të brendshme të Autoritetit të Konkurrencës” dhe konstatoi se për znj. Diana Dervishi duhet të fillojë procedimi disiplinor.

Në zbatim të nenit 57, pika 2 germa a); nenit 59, pika 6 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe VKM nr. 115 datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin , përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor”, Komisioni

Disiplinor i ngritur me Urdhrin nr. 20 datë 27 qershor 2023 “Për ngritjen e Komisionit Disiplinor”, vendosi pezullimin e nëpunësit civil, znj. Diana Dervishi, deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenet 27, pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Znj. Dhurata Skenderi, me detyre drejtoresh në Drejtorinë e Analizës dhe Metodologjisë së Tregut, do të kryejë përkohësisht detyrat funksionale të Sekretarit të Përgjithshëm deri në një vendim marrje tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


KOMISIONI I KONKURRENCËS

Leida MATJA

Zv/Kryetar

Rezana KONOMI

Anëtar

Adriana BERBERI

Anëtar


Denar BIBA
Kryetar